REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
MINISTRI

AGJENCIA KOMBËTARE E PYJEVE
Nr. 505 Prot.
Datë, më 30.04.2026

Nr. 2405/1 Prot. Datë 29. 4 .2026

UDHËZIM

Nr. 2, datë 29. 4, 2026

PËR

TË DREJTËN E DAMKIMIT, ADMINISTRIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË ÇEKIÇDAMKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës (c), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet", i ndryshuar dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.614, datë 23.10.2025 "Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standardet e tyre"

UDHËZOJ:

1. Damkimi kryhet me çekiçdamkë nga specialistët e strukturave përgjegjëse për pyjet pranë bashkive sipas kritereve dhe pas plotësimit të kërkesave teknike të përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të nenit 3, si dhe aneksin nr. 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.
2. Forma dhe karakteristikat teknike të çekiçdamkës janë sipas parashikimeve të shkronjës "c" të nenit 2 dhe kreut III të aneksit nr. 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.
3. Çekiçdamkat prodhohen dhe shpërndahen nga agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet që administron edhe informacionin për numrin total të çekiçdamkave të shpërndarë si dhe shenjat përkatëse sipas bashkive.
4. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, janë përgjegjëse për administrimin e çekiçdamkës dhe gjithë procesin e damkimit sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.
5. Kryetari i bashkisë ose i autorizuari prej tij, sipas rastit, nxjerr urdhrin me shkrim për organizimin e procesit të damkimit. Në urdhër përcaktohet data e fillimit dhe mbarimit të këtij procesi, e cila duhet të jetë brenda periudhës maj-korrik , specialistët e damkimit, sipas kritereve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025 dhe ngastrat/nënngastrat ku do të damkosë secili prej tyre. Nuk lejohet që dy apo disa specialistë të damkosin në të njëjtën ngastër apo nënngastër pyjore.

6. Për procesin e damkosjes mbahen në konsideratë parashikimet e kreut III, të Aneksit 1 të vendimit Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 23.10.2025.
7. Drurët shënohen me çekiçdamkë në pjesën e poshtme të tyre, sa më afër sipërfaqes së tokës. Krahas damkës, në lartësinë 1.5 m, drurit i bëhet një shenjë, duke hequr një pjesë të lëvores me sëpatë. Damka dhe shenja vendosen në shpat nga lart poshtë.
8. Nuk lejohet damkimi i llojeve të listës së kuqe, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 04.12.2003, "Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje".
9. Ngarkohen bashkitë, struktura përgjegjëse për pyjet në ministri dhe agjencia shtetërore përgjegjëse për pyjet për zbatimin e këtij udhëzimi.
10. Ngarkohet struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, për njoftimin e këtij udhëzimi, institucioneve të parashikuara në pikën 9 të tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Sofjan JAUPAJ

